



e Rahovecit

Komuna e Rahovecit krijon fond shpërblimi për raportimet për ndotje të mjedisit

Komuna e Rahovecit ka krijuar një fond shpërblimi për qytetarët që raportojnë ndotje mjedisore, me anë të informatave me fotografi apo me video të bazuara në fakte me qëllim të identifikimit të ndotësve duke hedhur mbeturina, për ndotje të lumenjve apo të pyjeve, djegie të mbeturinave dhe dëmtimeve të hapësirave të gjelbra.



Komuna e Rahovecit rrit përkrahjen për kulturën, rininë dhe sportin

U nënshkruan kontratat me ojq-të përfituese të subvencioneve nga fusha e kulturës, e rinisë dhe e sportit.

Nga gjithsej 31 ojq që aplikuan në thirrjen e DKRS-së, 30 prej tyre morën përkrahje.

Vlera e përgjithshme e financimit për këtë vit është 223,800€, që paraqet një rritje prej 18.06% krahasuar me vitin 2024.



Përkrahje për kultivuesit e specave dhe të trangujve

Komuna e Rahovecit ka nënshkruar kontratë me kompaninë «Agro Celina» Sh. P. K., për t'i mbështetur ata që punojnë tokën.

Me anë të kësaj kontrate do të mbulohen: fidanët, plehu kristalor, mulqerimi, sistemi pikë-pikë dhe ambalazhimi.

